



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**  
**KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN**



**VENDIM**

**Nr.05, datë 01.12.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES, PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR TË PËRROIT TË HOLTËS, DEGË KJO E LUMIT DEVOLL PËR "HEC HOLTA KABASH", NGA SUBJEKTI "HEC KABASH-POROÇAN" SH.P.K NË BASHKINË GRAMSH QARKU ELBASAN, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", si dhe të VKM Nr.416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6 datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" "Për pajisjen me leje, të subjektit "Hec Kabash-Poroçan" sh.p.k me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman

**V E N D O S I:**

1. Shfuqizimi i lejes Nr 2/2 date 24.02.2009 të dhënë subjektit "Hec Kabash Poroçan" sh.p.k nga Këshilli i Basenit Shkumbin.
2. Miratimin e lejes, për përdorimin të burimit ujor të Holtës degë e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie, nga subjekti "Hec Kabash Poroçan" sh.p.k, në Bashkinë Gramsh, Qarku Elbasan.
3. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBU SEMAN**  
**BAKI BALA**

